REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 885/20
Datë/Datum. 04.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT "PRISHTINA" SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**70433736-20-252-1-2-1**
Nr i brendshëm	**KRUP-20-009-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material elektrik**

ANKESË

1. **Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK**

"ELEKTRO – GG SH.P.K."
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

"Rruga e Vushtrrisë" Nr. 5
(Adresa)

PRISHTINË — **10000**
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044 600 191
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

QENDRIM GASHI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@elektrogg.com
(Adresa elektronike)

03.11.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës — *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K ELEKTRO-GG PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

ARBËR REXHA
(Emri i avokatit)

Rruga UCK, 101/5, 10000, Prishtinë

(Adresa e plotë)

045/656-678

(Numri i Telefonit)
(Numri i faks-it)

arber_rexha@hotmail.com
(Adresa elektronike)

AVOKAT - ATTORNEY AT LAW
Arbër Rexha B. I.
+377(0) 45 656 678
arber_rexha@hotmail.com
Rr. UÇK, Nr. 101/5, 10 000 Prishtinë - Kosovë

03.11.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Furnizim më Material Elektrik.**

Njoftimi për kontrate është bërë me datën 07.02.2020 ndërsa hapja publike është bërë më 02.03.2020.

Njoftimi i parë mbi vendimin e AK-së është bërë më datë 28.04.2020 ku parashtruesi i ankesës ishte shpallur fitues i tenderit. Pas një ankese nga një OE i pakënaqur me vendimin lënda kthehet në ri-vlerësim nga OSHP.

Njoftimi i dytë mbi vendimin e AK-së është bërë më datë 10.07.2020. Pas kërkesës për rishqyrtim AK shpall fituese të tenderit ELEKTRO GG SH.P.K.

Ndërsa, pas ankesës se një OE të pakënaqur drejtuar OSHP-së, më datë 09.10.2020, sipas vendimit të OSHP-së, lënda është kthyer ne rivlerësim nga OSHP.

Njoftimi i trete mbi vendimin e AK është bërë më datë: 21.10.2020. Të pakënaqur me këtë vendim dhe në afat të rregullt kohor, Elektro GG Sh.P.K., i është drejtuar AK-së me Kërkesë për Ri-shqyrtim. Ndërsa, më datë 26.10.2020 AK ka marrë vendimin mbi refuzimin e kërkesës për Ri-shqyrtim si të pa bazuar.

Andaj, të pakënaqur me vendimin e AK-së, për dhënien e kontratës të datës 20.10.2020, si dhe të pakënaqur me vendimin e AK-së, të datës 26.10.2020, me të cilin kërkesa e për Ri-shqyrtim është cilësuar si e pabazë, Elektro GG Sh.P.K., përmes përfaqësuesit Avokatit Arbër Rexha, i drejtohet OSHP-së.

Kriteri për vlerësim ka qenë **Tenderi i Përgjegjshëm me Çmim më të ulët me çmime të peshuara në bazë të rëndësisë.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.
Bashkangjitur do te gjeni vendimin pas kërkesës për rishqyrtim nga ana e jonë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë zhvillimit te kësaj procedure ka shkelur këto dispozita të LPP-së:

1. **AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së**
2. **AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe nenin 41 të RrUOPP-së**
3. **AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së**
4. **AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së dhe rregulloren B57**
5. **AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së**
6. **AK ka shkelur nenin 71 të LPP-së**
7. **AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues (*tutje referuar si "AK"*) me njoftimin e datës 20.10.2020, të publikuar më datë 21.10.2020 ka shpërblyer me dhënien e kontratës Grupin e Operatorëve Ekonomik Central Group Company Sh.P.K., dhe EL-BAU Sh.P.K., (tutje "Grupi I OE"), ndërsa pas kërkesës për ri-shqyrtim të ushtruar nga OE ELEKTRO GG SH.P.K., AK me vendimin e datës 26.10.2020, e ka refuzuar kërkesën për ri-shqyrtim si të pabazë.

Të pakënaqur me këtë, Elektro GG SH.P.K., përfaqësuar nga Avokat Arbër Rexha nga Prishtina, konform Nenit 109 të Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (*tutje referuar si "LPP"*) i drejtohet Organit Shqyrtues të Prokurimit (*tutje referuar si "OSHP"*) me këtë **ANKESË**;

Pas vlerësimit dhe analizimit të vendimit të lartcekur, konsiderojmë se vendimi i atakuar është marr me një sërë shkeljesh të dispozitave të LPP-së. Shkeljet e dispozitave të LPP-së kanë të bëjnë si vijon:

Shkeljet nga Neni 108/A i LPP-së:

Si fillim, vlen të theksohet se AK, me vendimin mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim, të datës 26.10.2020 ka shkelur dispozitat e LPP-së, përkatësisht **Nenin 108/A, paragrafi 12**, në lidhmëni me paragrafin 9 të të njëjtit nen, pasi që nuk ka arsyetuar fare vendimin mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim të dorëzuar nga Elektro GG Sh.P.K.

AK, në vendimin e sipërcekur e ka arsyetuar se kinse e ka bazuar në rekomandimet e OSHP-së të dhëna në Vendimin P.SH.nr.562/20, të datës 09.10.2020, mirëpo nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse pretendimet e palës ankuese janë të pa-baza.

Çdo vendim i një autoriteti kontraktues duhet të përmbaj **i)** pjesën hyrëse, **ii)** dispozitivin dhe **iii)** arsyetimin. *Ndërsa, arsyetimi duhet të përmbaj një shpjegim të situatës faktike; shkaqet vendimtare të cilat kanë pasur rol vendimtar në nxjerrjen e vendimit; bazën ligjore; si dhe shkaqet për të cilat nuk është pranuar apo refuzuar ndonjëri nga pretendimet e palës.* Ndërsa, AK në vendimin e saj nuk ka arsyetuar fare se pse pretendimet e palës ankuese janë të pa-baza. Andaj, vendimi i nxjerr në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, përkatësisht në kundërshtim me Nenin 108/A, par. 12 është i paligjshëm.

Një arsyetim i tillë i AK, përveç se është në kundërshtim me Nenin 108/A, par.12, të LPP-së, i njejti nuk mund të konstatohet se është në përputhshmëri me rekomandimet e OSHP-së. Kjo për faktin se OSHP me vendimin P.SH.562/20, të datës 09.10.2020 ka udhëzuar AK-në që përgjatë ri-vlerësimit, të kërkoj sqarime shtesë konform Nenit 72 të LPP-së, lidhur me referencat për vlerën totale të kërkuar nga AK për furnizime të ngjashme, dhe asesi nuk e ka udhëzuar AK-në për dhënien e kontratës Grupit të OE, tani fituese e kontratës.

Shkeljet nga Neni 7 i LPP-së:

Me vendimin e atakuar, AK ka bërë shkelje nga Neni 7 i LPP-së, për arsye se përgjatë vlerësimit ka favorizuar një Operator Ekonomik të cilën edhe e ka shpallur fituese të tenderit. Neni 7 i LPP-së përcakton qartë se AK duhet me patjetër ti trajtoj të gjithë OE-të në mënyrë jo-diskriminuese dhe të barabartë, ndërsa në kundërshtim me parimin për trajtim të barabartë të paraparë me këtë nen, AK ka shpallur fituese një OE e cila nuk i plotëson kushtet e parapara me LPP dhe me dosjen e tenderit *(tutje referuar si "FDT")*. OE-së të shpallur fituese nga AK, është grup i operatorëve ekonomik, mirëpo ju mungojnë Marrëveshja e konzorciumit si dhe tre (3) deklaratat përcjellëse, siç edhe kërkohen në pikën 11.1 të FDT-së (Shih pikën 11.1 të FDT-së), dhe Nenit 71 të LPP-së.

Si palë ankuese, Elektro GG Sh.P.K., i është drejtuar dy herë AK-së me kërkesë për qasje në dokumentet publikë, ndërsa në asnjërën nga dokumentet e ofruara nga AK sipas kërkesës për qasje nuk kemi gjetur se Grupi i OE fituese ka dorëzuar dokumentet sipas pikës 11.1 të FDT-së dhe Nenit 71 të LPP-së

- *Provë: shih kërkesën për qasje në dokumente të datës 13.07.2020, kërkesën për qasje në dokumente të datës 21.10.2018.*
- *si dhe përgjigjen e AK-së të datës 15.07.2020;*

Formulari i gjetur në shkresat e lëndës (formulari c), me të cilin Grupi i OE fituese ka tentuar ti mbuloj kërkesat nga pika 11.1 e FDT-së, është tip i formularit i cili përdoret për tenderët të cilët duhet dorëzuar fizikisht, dhe jo për tenderët dorëzimi i të cilëve kërkohet të bëhet në mënyrë elektronike si në rastin konkret. Andaj, ky formular, kinse marrëveshje asesi nuk mund të konsiderohet se mbulon marrëveshjen për konzorcium dhe deklaratat përcjellëse të kërkuara me FDT dhe LPP.

Shkeljet nga Neni 59 i LPP-së:

Shkeljet nga kjo dispozitë kanë të bëjnë me faktin se gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, AK nuk ka respektuar fare Nenin 59 (4) të LPP-së. Ky nen përcakton qartë se ***"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".***

Tenderi i Grupit të OE-së e cila edhe është shpallur fituese ka mangësi të konsiderueshme në dosjen e tenderit pasi që të njëjtës i mungojnë marrëveshja e konzorciumit dhe deklaratat përcjellëse të përcaktuara në Nenin 71 të LPP-së. Poashtu, Grupit të OE fituese i mungojnë edhe referenca mbi furnizime të ngjashme për tre (3) vitet e shkuara në vlerë prej EUR 100,000.00, dhe shumicën e çmimeve nëpër pozicione i ka jo-normalisht të ulëta.

Neni 71 (2) i LPP-së përcakton qartë se nëse një tender dorëzohet nga një Grup i OE-ve, grupi duhet së bashku me tenderin të dorëzoj marrëveshjen për konzorcium si dhe tri (3) deklarata përcjellëse, përfshirë këtu një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtareve, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marr pjesë në mënyrë individuale apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njejtë të prokurimit. Në rastin konkret, Grupit të OE fituese i mungojnë dokumentet/deklaratat e lartcekura, çka e bënë vendimin e AK për shpallje fitues të këtij grupi të paligjshëm, dhe në kundërshtim me Nenin 71 (2) të LPP-së si dhe pikën 11.1 të FDT-së.

Nisur nga kjo gjendje faktike, rezulton se grupi i OE fituese është tenderues i papërgjegjshëm dhe i njëjti grup është dashur të eliminohet.

Shkeljet nga Neni 69 i LPP-së:

Shkeljet nga kjo dispozitë kanë të bëjnë me faktin se AK ka shpallur fituese një Grup të OE-ve të cilëve ju mungon aftësia teknike/profesionale siç kërkohet nga Neni 69 i LPP-së, si dhe me pikën 9 të FDT-së.

Përgjatë këtij aktiviteti të prokurimit, OE fituese asnjëherë nuk ka dëshmuar aftësinë teknike/profesionale, çka e bënë këtë OE të papërshtatshme për tu shpallur fituese.

Ndërsa, AK në procedurë të mëhershme e kishte eliminuar OE-në fituese pikërisht për shkak të faktit se tani fituesi i kontratës nuk ka dëshmuar aftësinë teknike/profesionale. Mirëpo, pas kthimit të çështjes në ri-vlerësim nga OSHP, çuditërisht AK shpall fituese një OE të papërshtatshme.

Pala ankuese, edhe në kërkesën për ri-shqyrtim kishte përmendur këtë mangësi të OE fituese, mirëpo AK tani ka refuzuar kërkesën e ankuesit me pretendim se ka zbatuar vendimin e OSHP-së PSH.nr.562/20.

AK me vendimin e ankimuar ka vepruar në kundërshtim me udhëzimet e dhëna nga OSHP sipas vendimit PSH.nr.562/20. Me vendimin e cekur, ***Paneli Shqyrtues e ka obliguar AK-në që gjatë ri-vlerësimit të kërkoj sqarime shtesë konform Nenit 72 të LPP-së sa i përket referencave për vlerën totale për furnizime të ngjashme siç kërkohet me Nenin 69 të LPP-së dhe pikën 9 të FDT-së***. Ndërsa, AK, edhe përkundër që Grupi i OE fituese ***nuk i ka ofruar sqarime shtesë për vlerën totale të furnizimeve të ngjashme***, në kundërshtim me udhëzimet e OSHP-së, në kundërshtim me Nenin 69 dhe në kundërshtim me vet kërkesat e paraqitura në pikën 9.1 dhe 9.2 të FDT-së, shpall fitues Grupin e OE i cili nuk i plotëson kushtet teknike dhe profesionale për këtë tender.

Vlen të theksohet fakti se, si fillim, Grupi i OE fituese kishte dorëzuar tre (3) referenca me synim që të vërtetoj aftësinë teknike/profesionale, mirëpo tani pas kthimit të çështjes në rishqyrtim nga OSHP, Grupi i OE fituese, ***në vend se të jap sqarime për këto tre (3) referenca dhe të kalkuloj vlerën totale për furnizime të ngjashme, të njëjtit kanë dorëzuar dy (2) referenca tjera shtese me synim për të provuar aftësinë profesionale, ndërsa AK këtë veprim të OE e ka cilësuar si të rregullt duke e shpallur edhe fituese të kontratës***.

Grupi i OE fituese nuk ka arritur të dëshmoj aftësitë teknike/profesionale siç kërkohet me Nenin 69 LPP-së dhe pikën 9 të FDT-së. Vendimi për dhënien e kontratës Grupit të OE fituese, është i paligjshëm për arsye se ***referencat e dorëzuara nga ky grup ndërlidhen me kryerjen e punëve të ndërtimit dhe asfaltimit***, mirëpo asesi nuk janë të ngjashme me kontratën, përkatësisht fare nuk kanë të bëjnë me furnizime me material elektrik. Asnjë nga tre referencat e dorëzuara nuk ka të bëjë me furnizime me material elektrik por me ***punë dhe ndërtime***, e njejta vlen edhe për dy (2) referencat e dorëzuara sipas kërkesës së AK-së të cilat edhe ashtu janë të vonshme dhe në kundërshtim me nenin 79 (3) të LPP-së.

Është jashtë çdo logjike shpallja fitues të një Grupi të OE duke u bazuar në referenca nga të cilat qartë vërehet se referencat kanë të bëjnë me ***PUNË TË ASFALTIT dhe JO FURNIZIME ME MATERIAL ELEKTRIK,*** siç kërkohet në këtë tender.

Bazuar në RrUOPP, përkatësisht në pikën 15.2 të kësaj Rregullore, Kontratat ndahen në tre (3) lloje, dhe atë në ***i) Kontrata për Furnizime; ii) Kontrata për Shërbime, si dhe; iii) Kontrata për Punë***. Në anën tjetër AK në FDT ka përcaktuar qartë se kemi të bëjmë me Kontratë për furnizime me material elektrik, andaj referencat e tilla që kanë të bëjnë me kryerjen e shërbimeve apo punëve, të ofruara nga Grupi i OE fituese janë të papranueshme. (***Shih pikën 1.2 të FDT-së ku theksohet se kemi të bëjmë me "KONTRATË PËR FURNIZIME ME MATERIAL ELEKTRIK"***).

Poashtu, bazuar edhe në vetë vlerësimet e mëhershme të dhëna nga OSHP, kjo e fundit ka dhënë mendim dhe sqarim se referencat të cilat kanë të bëjnë me kontrata për ndërtim nuk gjejnë zbatim tek tenderët kërkesa e të cilëve ka të bëjë me furnizim.

- ***Provë: shih vendimin e OSHP-së, P.SH.nr.06/20, të datës 26.02.2020, faqe 8, paragrafi i fundit.***

Vetë fakti se Grupi i OE fituese dështon për të tretën herë radhazi që të ofroj dëshmi të specifikuara lidhur me furnizime të ngjashme me material elektrik është tregues i qartë së ky grup fare nuk i plotëson kërkesat *teknike/profesionale* të kërkuara nga Neni 69 dhe pika 9 e FDT-së.

Për më tepër, referencat e Grupit të OE fituese, apo thënë më mirë Punët e kryera nga Grupi i OE fituese ndërlidhen dhe specifikisht kanë të bëjnë me ndërtimtari dhe jo me furnizime

me material elektrik. Pra, ***AK ka shpallur fituese Grupin e OE i cili grup ka dorëzuar referenca që nuk lidhen fare me projektin në fjalë dhe bien ndesh me vet kërkesat e AK-së, duke hapur dilema se çfarë konkretisht kërkon AK, Furnizim me material elektrik, apo kryerje të punëve të asfaltimit.***

AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-në pasi që nuk ka aplikuar fare dispozitat nga Neni 69.

Neni 69, përcakton si vijon:

2. Gjatë udhëheqjes së procedurave që shpien drejt dhënies së kontratës publike në të cilën përfshihet livrimin i produkteve, nga operatorët ekonomik mund të kërkohet që të dëshmojnë aftësinë e tyre teknike përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të produkteve që duhet të furnizohen:

2.1. listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatori ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;

Sipas dispozitës së sipërcekur qartë kërkohet nga OE që në mënyrë specifike të saktësoj produktet e furnizuara dhe nëse këto produkte arrijnë shumën e kërkuar nga AK për vërtetimin e aftësisë teknike/profesionale.

Poashtu, bazuar edhe në Raportin e Ekspertit Shqyrtues, i dorëzuar më 26.08.2020, AK është udhëzuar ***që të kërkoj sqarime shtese lidhur me pozicionet e paramasës, përkatësisht pozicionet lidhur me ngjashmërinë e projektit TI KALKULOJ dhe ti vërtetoj nëse mbulohet vet kërkesa e AK-së.***

- ***Provë: Shih raportin e ekspertit faqe 5, paragrafi 3, si dhe Vendimin PSH.nr.562/20, faqe 5, paragrafi 1.***

Tani, edhe përkundër udhëzimeve të dhëna nga eksperti por edhe udhëzimeve të dhëna në vendimin e OSHP-së, P.SH.nr.562/20, Grupi i OE fituese nuk ka dhënë sqarime lidhur me paramasat dhe lidhur me atë nëse nga referencat e dorëzuara në bazë të kalkulimeve mbulohet kërkesa e AK-së. Në asnjë nga referencat nuk është kalkuluar sasia dhe shuma e furnizimeve me material elektrik dhe si të tilla këto referenca janë të papranueshme. Ndërsa, AK në mungesë të këtyre sqarimeve dhe në kundërshtim me Nenin 72 (3) të LPP-së, pranon referenca shtesë të cilat fare nuk kanë të bëjnë me furnizime të ngjashme dhe njëherit shpall fituese Grupin e OE.

Veprimi i AK-së për dhënien e kontratës Grupit të OE fituese pa pranuar sqarime lidhur me pozicionet e paramases, pozicionet lidhur me ngjashmëritë e projektit dhe kalkulimin e vlerave për të vërtetuar nëse mbulohet kërkesa e AK-së, bie ndesh me udhëzimet e OSHP-së, me sugjerimet e ekspertit shqyrtuese si dhe me dispozitat e LPP-së, andaj vendimi i ankimuar doemos duhet anulohet si juridikisht i paqëndrueshëm.

Shkeljet nga Neni 61 i LPP-së:

Me vendimin e ankimuar, AK ka shpallur fituese një OE e cila ka ofruar çmime nëpër pozicione të cilat çmime janë jo-normalisht të ulëta. Neni 61 i LPP-së parasheh si vijon:

Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:

2.1. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara. "

Në anën tjetër KRPP-ja ka nxjerr akt nënligjor, përkatësisht rregulloren B57 (të versioni i korrigjuar) e cila rregullon në hollësi përcaktimin e çmimit jo-normalisht të ulët. Sipas kësaj Rregullore, për tu konsideruar një tenderues se ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta duhet të plotësohen kushtet si vijo;

- *Të jenë dorëzuar së paku 3 (tre) tender*
- *Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm, si dhe;*
- *Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët*

Në rastin konkret, çmimet e ofruara nëpër shumicën e pozicioneve nga Grupi i OE fituese janë çmime të cilat i plotësojnë kushtet e lartcekura për tu konsideruar si çmime jo-normalisht të ulëta

- *Provë: shih tabelën për pozicionet të cilat janë ofruar me çmime jo-normalisht të ulët, të bashkangjitur në këtë ankesë*

Andaj, AK është dashur ti aplikoj dispozitat nga neni 61 i LPP-së dhe Rregullorja B57, dhe të kërkoj sqarime për çmimet e ofruara nëpër pozicione të cilat të cilat i plotësojnë kushtet për tu konsideruar çmime jo-normalisht të ulëta. Në këtë situatë konsiderojmë se është shkelur dispozita nga Neni 61 i LPP-së, si dhe Rregullorja B57

Qëllimi i Nenit 61 të LPP-së, si dispozitë që ka të bëjë me çmimet jo-normalisht të ulëta, ***është mbrojtja e interesit publik kundrejt rrezikut për mos-performance ose performancë të dobët të kontratës.***

Dhënia e kontratës një OE e cila ka ofertuat në thuajse të gjitha pozicionet me çmime jo-normalisht të ulëta përbën rrezik për ofrimin e materialeve të kualiteti të dobët, përbën rrezik për performancë të dobët të kontratës, ose rrezik për mos-përformancë të kontratës, si dhe ka për qëllim eliminimin e konkurrencës. Kjo është edhe arsyeja e përfshirjes së dispozitës nga Neni 61 në LPP, dhe si e tillë është dashur të aplikohet. Andaj, një autoritet kontraktues është nën obligim ligjore të kërkoj nga OE sqarim lidhur me çmimet e ofruara. E që në rastin

konkret AK është dashur edhe në këtë procedurë, sikurse në procedurë të mëhershme, të kërkoj nga Grupi i OE fituese sqarime lidhur me çmimet jo-normalisht të ulëta.

Përgjatë procedurës së mëhershme, AK kishte kërkuar sqarime lidhur me çmimet jo-normalisht të ulëta nëpër pozicione të ofruara nga Grupi i OE-së fituese, ndërsa kjo e fundit nuk kishte dhënë sqarime, por vetëm ka deklaruar se i qëndrojmë ofertës mbrapa. Një sqarim i tillë është i pamjaftueshëm dhe tregues i qartë se OE fituese nuk mundet ti arsyetoj çmimet jo-normalisht të ulëta çka rrezikon edhe mos-përmbushjen e kontratës.

Në anën tjetër, me kërkesën për ri-shqyrtim të datës 24.10.2020, këtu ankuesi kishte kërkuar nga AK që ta rishqyrtoj njoftimin për dhënien e kontratës dhe njëherit të kërkoj sqarime nga OE fituese lidhur me çmimet jo-normalisht të ulëta, por që AK ka refuzuar këtë kërkesë pa dhënë ndonjë sqarim mbi bazën ligjore.

Njëherit AK, edhe përgjatë kësaj procedurë është dashur t'i krahasoj të gjitha ofertat lidhur me çmimet e ofruara nëpër pozicione, e poashtu ti krahasoj edhe çmimet e tregut lidhur me çmimet tregut, e pastaj të kërkoj sqarime lidhur me këto çështje. Mos ndërmarrja e veprimeve konform Nenit 61 të LPP-së dhe Rregullores B57, e bënë vendimin e AK të ankimuar të paligjshëm.

Përfundim:

Konsiderojmë se vendimi i atakuar është në tërësi në kundërshtim me dispozitat e lartcekura, në kundërshti me udhëzimet e OSHP-së të dhëna në vendimin P.SH.nr.562/20, si dhe në kundërshtim me sugjerimet e ekspertit shqyrtues.

Dispozitat e shkelura të LPP-së, janë të natyrës imperative, të pandryshueshme të parapara në LPP, të cilat duhet me patjetër të respektohen nga në AK, dhe se as AK apo OSHP nuk mund të devijojnë nga këto dispozita, por që duhet tu binden atyre.

Mbi të lartcekurat, i propozojmë OSHP-se si organ i shkallës së dytë që të, shqyrtoj këtë ankesë, t'i shqyrtoj pretendimet ankimore, të administroj me provat e propozuara, po qe nevoja edhe me prova të tjera, pastaj të merr këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, në tërësi si e bazuar ankesa e OE-së - Elektro GG SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull *"Furnizim me material elektrik"*, me numër të prokurimit 704033736-20-252-1-2-1, inicuar nga Autoriteti Kontraktues KRU Prishtina, ashtu që;

II. **ANULOHET**, njoftimi i vendimit për dhënien e kontratës, i datës 21.10.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull *"Furnizimi me material elektrik"*, me numër të prokurimit 704033736-20-252-1-2-1, inicuar nga Autoriteti Kontraktues KRU Prishtina, dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim.

III. **KTHEHEN**, mjetet e deponuara në emër të tarifës së ankesës në shumën e deponuara në vlerë prej EUR 800,00 OE-së, Elektro GG SH.P.K..

Ri-vlerësimi të bëhet duke u bazuar plotësisht në **kërkesat e dosjes së tenderit** dhe në dispozitat e LPP-së si dhe në rregulloret shtesë të aprovuara nga KRPP, e që më pas do duhej që **Fitues** te shpallej **OE "ELEKTRO – GG SH.P.K."**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale i shkaktohen operatorit ekonomik ELEKTRO GG SH.P.K., nëse shpallet fituese e kësaj kontrate janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.

Poashtu, mos-dhënia e kontratës operatorit ekonomik ELEKTRO GG SH.P.K., rezulton me dëm jo-material, përkatësisht me dëmtim/denigrim të reputacionit si një kompani serioze, me një përvojë dhe afarizëm të gjatë në tregun Kosovar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *Autorizimin e datës 02 Nëntor 2020*
- *Njoftimi për Kontratë i datës 07.02.2020*
- *Njoftim për Vendimin E AK dhe Letrat Standarte 20.10.2020, publikuar më datë 21.10.2020*
- *Një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve*
- *Kërkesa për ri-shqyrtim e OE Elektro GG Sh.P.K.*
- *Vendimi mbi kërkesën për ri-shqyrtim i datës 26.10.2020*
- *Dosja e amandamentuar e tenderit në gjuhën shqipe*
- *Kërkesa për qasje në dokumente publike përmes email të datës 13.08.2020*
- *Kërkesa për qasje në dokumente publike e datës 21.10.2020*
- *Lista e referencave të dorëzuara nga El Bau Sh.P.K.*
- *Formulari C i FDT-së dorëzuar nga Grupi i OE, El Bau dhe Central Group*
- *Lista Çmimet jo-normalisht të ulëta*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*